



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-10
Prishtinë, më 19 janar 2015, ora 20:00

PROCESVERBAL

I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19 JANAR 2015

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 73 deputetë.

Kryetari, në bazë të vendimit të Kuvendit nr. 05-V-011, datë 19.1.2015, procedoi me këtë

Rend dite

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme, në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 05-V-011, të datës 19 janar 2015, e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Raportin e Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri e paraqiti dhe e arsyetoi kryetari i këtij komisioni, Muhamet Mustafa.

Pastaj, kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara, një nga një.

Kuvendi i miratoi amendamentet: 1 dhe 2.

Kryetari e hodhi në votim miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi Ligjin nr. 05/L-08 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 20:47 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale